



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENJE SOCIALE

Uprava za zdravstvo I Socialnu Zastitu /Department of Health and Social Welfare
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “ Dr.Vezir Bajrami” Shtime

Nr.111/ 50

Date: 22.02.2019

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L -212 “G.Zyrtare “ nr.90 datë:1/12/2010, nenit 4 alinea 1 e Udhezimit Administrativ nr. 16 . 2017, nenit 5 të Kontratës Kolektive Sektoriale, Qershor 2018 , Qarkores informuese të Ministrisë së Financave Nr.48 pika 2 nën c, datë 19.02.2016, Drejtoresha e QKMF “Dr Vezir Bajrami “ në Shtime publikon :

KONKURS

**Për plotësimin e vendit të lirë të punës për kohë të pacaktuar
1 (një) Infermier/e - Vozitës-e në QKMF – Urgjencë**

KUSHTET :


- Bachelor – Dega Infermieri e përgjithshme ose Shkolla e mesme e mjekësisë – drejtimi i përgjithshëm
- Licenca e Punës valide dhe Lejen e vozitjes (Patent shofer) valid të lëshuar nga organet e Republikës së Kosovës;
- Paga : koeficient H-66

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Udhëheq dokumentacionin e të sëmuarëve , ftesave, urdhëresave, kartelet e intervenimeve dhe i futë të dhënat e nevojshme në kompjuter.
- Asiston në dhënjën e ndihmës urgjente, opservimit, kirurgjisë së vogël, duke bërë reanimimin kardio-pulmonar-cerebrar, përdorimin e defibrilatorit, EKG, monitorit, ndaljen e gjakderdhjes, dhënjën e antishok terapisë ,bënë observimin e të sëmurëve në ambulancë apo jashtë.
- Eshhtë antar i rregullt i ekipit mjekësor, në qendër në shtëpi, banesë, rrugë dhe çdo hapsirë tjetër si dhe në ekipet transportuese,
- Te ketë njohuri për punën e paisjeve të aparaturës në autoambulancë, qendër dhe është përgjegjës për funksionimin e tyre
- E ndihmon mjekun në triazhimin e të sëmuarëve të lënduarëve etj.
- Transport të sigurt dhe trajtim gjatë transportit (brenda teritorit të komunës së Shtimes dhe në rast nevojje edhe jashtë saj , punon në ekipë;
- Ruan sekretin mjekësor në punën e përditëshme;
- Komunikon me Kryeinfermierin e urgjencës si dhe merr urdhera nga ai, njëkohësisht e vozitë edhe autoambulancën;
- Kryen edhe punë tjera nga fusha e përgjegjësisë.
- Kandidatët të cilët konkurojnë për këtë vend pune Aplikacionit duhet t’ia bashkangjesin: Diplomën mbi shkollimin e kryer, çertifikatën e lindjes, leternjoftimin, licencën e punës, çertifikatën e gjendjes shëndetësore si dhe cdo dokument tjetër trajnimi që kandidati-ja konsideron të vlefshëm për këtë vend pune.

Detajet mbi kualifikimet personale dhe profesionale duhet t’i bashkangjiten aplikacionit kurse origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistës.

Afati i konkursit është 15. ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimi dhe në web-faqen zyrtare: www.shtime-komuna.org. Aplikacionet për konkurim merren dhe dorëzohen në adresën : Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr. Vezir Bajrami” Shtime, Rr. “Anton Ceta” nr. 39.



Drejtori i QKMF “dr Vezir Bajrami”
Dr. Mirdita Qeriqi- Hajdari